

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6500  
E enjte, 30 dhjetor 2021  
çmimi 0.40 €

## Kurti: Bisedimet në Bruksel nuk kanë qenë të padobishme



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË MËRKURËN SEANCË PLENARE | FAQE 4-5

## KUVENDI MIRATON MASAT E EMERGJENCËS PËR ENERGJI ELEKTRIKE



Një ditë pas debatit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar masat e emergjencës për energji elektrike. Me 57 vota për, 17 abstenime dhe asnjë kundër, janë vendosur kufizimet në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë, kurse opozita i ka quajtur të vonuara masat emergjente për energji elektrike

### AKTUALE



DIMITAR KOVAČEVSKI MANDATOHET PËR KRYEMINISTËR TË MAQEDONISË SË VERIUT | F. 2

VELIU, ABDIXHIKUT: JE TEPËR I VOGËL T'UA MBYLLËSH DERËN GARDIANËVE TË LDK-së | F. 3

BULLIQI THOTË SE OPOZITA ËSHTË DUKE BLOKUAR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT | F. 6



### EKONOMI



ATK-ja: 591.4 MILIONË EURO TË INKASUARA OSE 34.5 MILIONË EURO MË SHUMË SE PROJEKSIONI PËR KËTË VIT | F. 8

### SPORT



KON-I 'KËRÇËNON' SERBINË PËR KOSOVËN | F. 10

### Oeveria miraton Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme



### DREJTORI I SHSKUK-së KËRKON ZBATIM TË PLANIT PËR MENAXHIMIN E PANDEMISË

| FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Dimitar Kovaçevski mandatohet për kryeministër të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 29 DHJETOR - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka mandatuar kryetarin e Lidhjes Social Demokratike (LSDM), Dimitar Kovaçevski, për postin e kryeministrit.

Kovaçevski dekreton e mori të mërkurën në kabinetin presidencial, pasi LSDM-ja paraprakisht e kishte njoftuar përmes një letre se ka siguruar shumicën në Kuvend për votimin e qeverisë së re. "Nga sot (e

mërkurë) filloj të formoj ekipin e ri me njerëz që duhet t'u përgjigjen sfidave serioze që na presin nga fillimi i vitit të ri. Qeveria e re do të ketë një synim të qartë të ofrojë siguri, jetë më të mirë dhe të ardhme të ndritur për qytetarët tanë. Angazhimi im personal është ta kthej besimin e qytetarëve në politikë dhe në institucionet e vendit. Kjo kërkon një qeverisje efikase, të ndershme dhe të përgjegjshme", ka deklaruar Kovaçevski.

Kryetari i LSDM-së do të ketë 20 ditë afat që të dorëzojë për miratim në Kuvend përbërjen e re të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, ka thënë se pret që qeveria e re ta nisë punën më së voni deri më 18 janar, pas paraprakisht të jetë votuar në Kuvend me 61 vota të deputetëve. Qeveria e re do të përbëhet nga LSDM-ja, Bashkimi Demokratik për Integritet, Alternativa dhe Partia Demokratike Shqiptare.



## Nëntë serbë të Bosnjës akuzohen për krime lufte



SARAJEVË, 29 DHJETOR - Zyra e Prokurorit të Bosnjës e Hercegovinës tha se ka ngritur aktakuzë ndaj nëntë serbëve të Bosnjës për vrasjen e mbi 100 boshnjakëve. Vrasjet thuhet se kanë ndodhur pak kohë pas nisjes së luftës në Bosnjë më 1992. Kjo aktakuzë është në vazhdim e disa aktakuzave që janë ngritur së fundmi në Bosnjë e Hercegovinë lidhur me krimet e luftës. Në njoftimin e Prokurorisë u tha

se nëntë ish-anëtarë dhe komandantë të ushtrisë së serbëve të Bosnjës dyshohet se janë përfshirë në vrasjen e dhjetëra grave, të moshuarve dhe fëmijëve nga 2 deri në 15 vjeç në zonën Nevesinje, të dominuar nga serbët, në juglindje të Bosnjës. "Mbetjet mortore të 49 personave janë gjetur, ndërkaq 47 viktima ende konsiderohen të pagjetur", u tha në njoftimin e Zyrës së Prokurorit. Të dyshuarit u arrestuan më 16 dhjetor.

Prokuroria tha se në mesin e viktimave janë edhe shtatë familje që janë vrarë. Njoftimi për ngritjen e aktakuzës vjen në kohën kur janë kryer disa arrestime për krime lufte nga Agjencia për Hetime dhe Mbrojtje e Bosnjës e Hercegovinës. Bosnja shpalli pavarësinë më 1992 që nxitoi konfliktin e viteve 1992-95, ku u vranë pothuajse 100 mijë persona dhe u zhvendosën mbi 2 milionë të tjerë.

## Franca regjistron mbi 200 mijë raste të reja me Covid-19

PARIS, 29 DHJETOR - Franca ka regjistruar numër rekord të infektiveve ditore. Ministri i Shëndetësisë, Olivier Veran, tha se në këtë vend janë regjistruar 208 mijë raste të reja me koronavirus.

Të martën Franca, po ashtu, kishte shënuar rekord të rasteve plot 180 mijë, duke u bërë shteti me numrin më të lartë të rasteve të reja në Evropë. "Sipas shifrave të reja, i bie që çdo minutë dy persona në Francë dalin pozitivë

me koronavirus", tha Veran. Ministri i Shëndetësisë tha se situata në spitale është shqetësuese për shkak të variantit Delta. Ai shtoi se ndikimi i variantit Omicron ende nuk po vërehet. Veran tha se edhe paraqitja e gripit stinor ka rënduar situatën në spitale. Javët e fundit shtetet në Evropë po përballen me rritje të infektiveve, teksa varianti Omicron i koronavirusit po

vazhdon të përhapet me shpejtësi. Ky variant fillimisht ishte detektuar në Afrikën e Jugut në nëntor, por tani ai besohet se është përhapur në mbi 100 shtete të botës. Ekspertët ende nuk e kanë përcaktuar nëse Omicroni, që është variant më ngjites, shkakton sëmundje më të rëndë sesa variantet paraprake apo nëse shmang imunitetin e vaksinave kundër koronavirusit.



## Gjermania blen një milion pilula nga "Pfizer" për trajtim të koronavirusit

BERLIN, 29 DHJETOR - Gjermania ka blerë një milion pilula për trajtim të koronavirusit nga kompania farmaceutike "Pfizer", ka thënë ministri gjerman i Shëndetësisë, Karl Lauterbach. Dërgesat e para të ilaçit me emrin Paxlovid pritet të arrijnë në Gjermani në muajin janar, ka thënë Lauterbach për agjencinë e lajmeve "dpa", duke shtuar se pilula është shumë premtuese. "Pres që përmes saj t'i parandalojmë rastet serioze të infektimit që përfundojnë në



kujdesin intensiv", ka thënë ai. Administrata amerikane për

Ushqim dhe Ilaçe (FDA) ka lëshuar miratim urgjent për këtë

pilulë. Ministri gjerman ka thënë se edhe shteti i tij i ka dhënë dritën e gjelbër këtij ilaçi. Sipas kompanisë prodhuese, pacientët duhet të marrin tri pilula në ditë për pesë ditë. Ndonëse ilaçet sikurse Paxlovid konsiderohen si armë e fuqishme për luftim të pandemisë, ato janë më të shtrenjta dhe më vështirë për t'u dhënë. Sipas të dhënave të Institutit "Robert Koch", Gjermania ka

vaksinuar 70.9 për qind të popullsisë kundër koronavirusit. Kjo i bie që 59 milionë banorë të Gjermanisë janë të vaksinuar plotësisht. Të paktën 30.4 milionë prej tyre kanë marrë edhe dozën përforcuese të vaksinës, apo 36.6 për qind e popullsisë. Autoritetet gjermane presin valë të re të infektiveve me koronavirus në muajin janar për shkak të përhapjes së variantit Omicron të këtij virusi.

## Veliu, Abdixhikut: Je tepër i vogël t'ua mbyllësh derën gardianëve të LDK-së

PRISHTINË, 29 DHJETOR (ER) - Ish-nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), deputeti Agim Veliu, i është kundërpërgjigjur ashpër kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhikut, pas ky i fundit, në një intervistë televizive, ka thënë se do t'i mbyllë dyert e partisë për disa njerëz që kanë pasur pushtet në LDK.

Abdixhiku ka thënë se në vend se të marrë përgjegjësi dhe bashkë me kandidatit e tij të kërkojnë falje për humbje në garë për Podujevën, Lumir Abdixhiku, që hyri nga dritarja në LDK, i paska marr çelësat e partisë që t'ua mbyllë derën e shtëpisë atyre që e ndërtuan dhe me sakrificë e mbajtën dhe e ngritën për 30 vjet. "Autokratit të katapultuar në krye të partisë, që paska kërcënuar me mbyllje dyersh e diferencime, ia bëj me dije se është anëtarësia e LDK-së ajo që vendos për vendin e secilit në parti dhe jo ai me vendime kundërstatutare. Heshtja e deritashme nuk do të thotë se unë si kryetar i Degës së LDK-së do të dorëzohem përballë ndërhyrjeve kundërligjore dhe kundërstatutare të Lumirit, në degën e Podujevës. Lokomotivisti Abdixhiku paska thënë se nuk do të ketë kthim mbrapa të trenit, të cilin ai tashmë e konsideron pronë të vetën. Këtë e dëshmoi në përvjetorin e 32-të të LDK-së, ku të pranishmit në sallë, i konsideroi si



wagonët e tij. 'Unë dhe ju'. Kështu iu drejtua Lumiri 'admiruesve' të tij në disa raste. Në 32-vjetorin e themelimit të LDK-së ai shkarazi përmendi kontributin e themeluesve të saj. Më pastaj 'lideri' i ri ishte përkujdesur ta ndajë LDK-në në katër dekada-periudha", ka thënë Veliu. Ai ka theksuar se në podiumin me logon e LDK-së, pa ngjyrat e saj identifikuese, "lideri" u tregoi

ndjekësve të tij se tash po fillon dekada e tij në parti dhe ai mund të ndërrojë jo veç ngjyrat, por edhe logon e partisë. "Lideri', që po shpërfaqte hapur tiparet narcisoide në formë çrregullimi, rrihte gjoks duke përsëritur refrenin: 'Unë dhe ju...' Lumiri i vogël, i katapultuar në vend të madh, ndjekësve të ekzaltuar harroi t'u thotë: 'S'ka rëndësi nëse deri dje jua kam sharë partinë,

liderët e veprimtarët. Sot jeni kopeja ime. Më ndiqni mua, shpëtimtarin tuaj'. Kërkoj ta ndjekim lokomotivën që ai drejton, pasi e di mirë se në cilët binarë synon ta çojë për ta realizuar ëndrrën e tij dhe të atyre që ia dhanë për mision ta bëjë këtë", ka thënë Veliu. Ai ka theksuar se "Lumirit, që tinëzishit hyri në LDK dhe luan rolin e gardianit me çelësa në dorë,

i them se je tepër i vogël t'ua mbyllësh dyert gardianëve të vërtetë që e ndërtuan LDK-në e madhe. LDK-ja nuk është një lodër që për fatin e saj të vendosë një tinxher politik. Prandaj, do të dështojë edhe misioni yt që trenin e LDK-së ta shndërrosh në një vagon, të cilin synon t'ia bashkëngjisësh lokomotivës së kuqe", ka thënë deputeti i LDK-së, Agim Veliu.

## Zjarrfikësit marrin pagesën e orëve shtesë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të mërkurën që ta bëjë pagesën për orë shtesë gjatë vitit 2021 për 766 zjarrfikës.

Ky vendim është marrë me kërkesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). "Ne si Ministri e Financave, Punës dhe Transfereve kemi pranuar kërkesën e MPB-së me arsyetimin për pagesën e orëve shtesë gjatë vitit 2021 për zjarrfikësit. Bëhet fjalë për 513 872 euro. Për zbatimin e këtij

vendimi përdoren mjete buxhetore në kategorinë e pagave dhe shtesave të organizatave buxhetore aty ku zjarrfikësit janë në listën e pagave", ka thënë ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati. Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave dhe njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politikë të Sigurisë (SPRC), ka thënë se ndarja e mjeteve për pagesën e orëve shtesë për zjarrfikësit duhet të bëhet çdo muaj siç e përcaktojnë ligjet e Kosovës. "Ndarja e mjeteve financiare nga Qeveria e

Kosovës, për pagesën e orëve shtesë, ndërrimeve të natës dhe punës gjatë festave, të vitit që po lëmë pas, për zjarrfikësit e Kosovës, është lajm mjaft i mirë për këtë kategori punëtorësh sakrifikes. Gjithsesi, krahas angazhimeve për rregullimin e statusit juridik të zjarrfikësve dhe përmirësimit të kushteve të punës, qeveria duhet të planifikojë me kohë buxhetin për vitin e ardhshëm dhe t'i ndajë mjetet e duhura financiare, në mënyrë që mjetet shtesë t'u paguhen zjarrfikësve çdo muaj, siç e përcaktojnë ligjet në fuqi të Kosovës", ka thënë Ahmeti.

## U lansua shërbimi për pagesa elektronike për qytetarët

PRISHTINË, 29 DHJETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe atë të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë marrë pjesë në lansimin e pagesave elektronike, përmes të cilit synohet lehtësimi dhe shkurtimi i kohës për marrjen e

shërbimeve qeveritare pa prani fizike. "Digjitalizimi, si objektivi kryesor i programit qeverisës, parashihet të jetë pjesë e të gjitha shtyllave në Strategjinë e re Kombëtare për Zhvillim", ka thënë kryeministri Kurti dhe ka shtuar se, përmes transformimit digjital, synohet përmirësimi i avancuar i administratës publike, sistemit

arsimor, sektorit të shëndetësisë, sistemit të drejtësisë dhe të gjitha fushat e tjera të qeverisjes. "Nëpërmjet zhvillimit të qeverisjes elektronike synojmë rritjen e transparencës, të llogaridhënies dhe përmirësimit të shërbimeve tona ndaj qytetarëve dhe bizneseve", është shprehur Kurti gjatë fjalës së tij.





KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË MËRKURËN SEANCË PLENARE

# Kuvendi miraton masat e emergjencës për energji elektrike

Një ditë pas debatit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar masat e emergjencës për energji elektrike. Me 57 vota për, 17 abstenime dhe asnjë kundër, janë vendosur kufizimet në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë. Kurse opozita i ka quajtur të vonuara masat emergjente për energji elektrike

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 29 DHJETOR** - Kuvendi i Kosovës ka miratuar të mërkurën vendimin e Qeverisë së Kosovës për masa emergjente për furnizimin me energji elektrike. Me 57 vota për, 17 abstenime dhe asnjë kundër janë vendosur kufizimet për furnizim me energji për konsumatorët dhe për vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

Një ditë më parë në Kuvend është zhvilluar një debat i gjatë për këtë çështje dhe në fund nuk ka pasur kuorum për miratim.

Deputetët e pozitës dhe të opozitës kanë shprehur qëndrime të kundërta për këtë

çështje. Sipas deputetëve të opozitës, ndërmarrja e këtyre masave është e vonshme. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se do të duhej të kishte një analizë të qartë të Ligjit për energjinë nga Qeveria e Kosovës për marrjen e këtij vendimi. "Vendimin që keni sjell sot në Kuvend, me vetëm dy pika, po dëshironi ta legalizoni ndërprerjen, po dëshironi ta legalizoni paligjshëm, pa logjikë ta dëmtoni konsumatorin. Ne kërkuam në seancën e kaluar që të merren masat emergjente. Kjo është paaftësi direkte menaxhuese, paaftësi organizative dhe ndikim politik në një ndërmarrje publike e cila e ka mbajtur barrën në situata tepër të vështira", ka thënë

Shala.

Kure kryetari i Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se qeveria nuk duhet të jetë ankuese dhe spektatore. "Ne sot jemi në fund të dhjetorit, katër ditë pa përfunduar viti, gjashtë muaj pas fillimit të krizës. Qeveria jonë populliste siç është, verës kur të tjerët merreshin me problemet e energjisë, e kur çmimet e energjisë rriteshin gjithandej, shpërndante parulla nëpër Evropë se e ka zhvillimin më të madh në Evropë aq të lartë sa që po e arrin edhe Kroacinë", është shprehur Abdixhiku.

Lidhur me krizën energjetike në Kosovë ka folur edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, duke sqaruar faktin fillimisht se ky debat është iniciuar nga grupi parlamentar i AAK-së. Ai ka thënë se kjo çështje është kërkuar nga AAK-ja para dy javësh për shkak të reduktimeve të rrymës. "Kam drejtuar pyetje për kryeministrin dhe kam marrë një përgjigje me shkrim, ndërsa sot do të jap disa vlerësime lidhur me veprimet që është dashur të ndërmerren

dhe që duhet të ndërmarrë kjo qeveri. Janë disa faktorë që e kanë sjellë Kosovën në këtë gjendje, mirëpo kulmi është arritur me qeverinë aktuale, e cila, duke qenë mbi 10 vjet opozitë dhe pjesë e institucioneve dhe që i ka ditur problemet me të cilat është ballafaquar vendi në këtë sektor, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, duke rrezikuar kështu shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve", ka deklaruar Haradinaj. Zgjidhja e këtij problemi, sipas tij, është neglizhuar dhe se kabineti qeveritar nuk ka dhënë sqarime se si do të dilet nga kjo krizë.

Haradinaj në vijim foli lidhur me veprimet afatshkurtra dhe ato afatgjata që duhen ndërmarrë. Fillimisht, sipas tij, duhet të ketë një vlerësim transparent mbi nevojat financiare për ta mbuluar koston e importit, përtej çmimit të importit, të aprovuar nga ZRRE-ja. Kjo, sipas tij, të paktën deri në prill të vitit të ardhshëm. Pas një diskutimi të gjerë të deputetëve, kritikave të opozitës lidhur me problemin

me energji elektrike u është kundërpërgjigjur ministrja Artane Rizvanolli, ndërsa sqarime shtesë dha edhe ministri Hekuran Murati.

Gjatë diskutimeve ministrja Rizvanolli adresoi kritika ndaj KEDS-it lidhur me aspekte të menaxhimit të këtij problemi. "Për t'i zbutur ndikimet e çmimit të importit në tarifa, qeveria subvencionoi miliona euro. Pavarësisht këtij fakti, Kosova vazhdon të devijojë sepse KEDS-i nuk po respekton rregullat e lojës. KEDS-u që nga data 20 dhjetor nuk e blenë tërë energjinë e nevojshme. Kësisoj, KOSTT-i po detyrohet të urdhërojë reduktime apo edhe subvencionim", ka theksuar ajo. Rizvanolli ka thënë se pret nga ZRRE-ja dhe KOSTT-i që të veprojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe se, sipas saj, KEDS-i po e trajton interesin e tij komercial para interesit publik. Ditë më parë kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se çmimet e larta të importit janë pasojë e faktorëve të jashtëm, ndërsaq dobësimi i kapaciteteve është pasojë e shkaqeve të brendshme. "Në njërin anë

## Kurti: Bisedimet në Bruksel nuk kanë qenë të padobishme

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën se është i gatshëm për takime në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian gjatë vitit 2022.

Në një konferencë për medie, pas mbledhjes së fundvitit të Qeverisë së Kosovës, Kurti ka thënë se procesi i bisedimeve në Bruksel gjatë vitit 2021 “nuk ka qenë i padobishëm”.

I pyetur lidhur me atë se a do të ketë rritje të intensitetit të

bisedimeve gjatë vitit pasues, Kurti ka thënë se duhet gatishmëri më e madhe edhe nga Serbia. “Duhet të ndryshojë pakrahasimisht më shumë Serbia. Se kur zhvillohen takimet në Bruksel nuk varet prej meje, duke qenë se unë kam shprehur gatishmërinë time. Besoj që në vitin e ardhshëm do të ketë edhe ftesa përkatëse për një dialog që i kontribuon paqes së qëndrueshme”, ka deklaruar Kurti.

Ai e ka konsideruar “arritje të

mirë” të dialogut marrëveshjen e përkohshme lidhur me targa e automjeteve, që ka mundësuar zhblokimin e pikave kufitare mes dy vendeve.

Më 20 shtator 2021 Qeveria e Kosovës pati nisur zbatimin e masës së reciprocitetit në targa të makinave, që nënkupton se makinat e regjistruara në Serbi duhet t'i largonin targa e tyre në pikën e parë kufitare me Kosovën dhe të vendosnin

targa të përkohshme. Kjo masë është përcjellë me shumë pakënaqësi të serbëve lokalë, të cilët patën bllokuar pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak.

Më 30 shtator është arritur marrëveshja në mes të palëve në Bruksel, që parashihte largimin e bllokadave nga rrugët, largimin e njësive speciale dhe vendosjen e letrave ngjitëse në targa e automjeteve, në pjesën ku shihen simbolet shtetërore. Kjo marrëveshje është në

fuqi deri në prill të vitit 2022, kur edhe duhet të pasohet nga një marrëveshje përfundimtare.

Gjatë vitit 2021 kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, janë takuar dy herë - në qershor dhe në korrik.

Në asnjërin prej këtyre takimeve nuk është arritur ndonjë marrëveshje.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011.



çmimi i energjisë në bursë është shtatëfishuar: ishte rreth 70 euro për MWh në kushte normale, kurse më 21 dhjetor mbërriti deri në 515 euro! Në anën tjetër, as gjysma e konsumit të ne nuk mbulohet nga prodhimi: kërkesa ka arritur pikun historik me 1,4 GW, ndërsa në rastin më të mirë (derisa ta riparojmë bllokun B2 me fuqi prej 255 MW)

termoelektranat tona nuk gjenerojnë as 650 MW! Në këtë situatë nuk ka zgjidhje të mirë: ose reduktime të energjisë, ose shtrenjtim të energjisë? Shumë më herët Kosova është dashur të mendojë më shumë e më mirë, që të mos përfundojë në këtë gjendje të keqe”, ka shkruar Kurti në profilin e vet në “Facebook”.

Masat emergjente të furnizimit

me energji përfshijnë vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

Me propozim të qeverisë parashihet themelimi i një Komiteti Teknik Emergjent me qëllim të identifikimit dhe paraqitjes së rekomandimeve të Ministrja e Ekonomisë.

Ky komitet ka për detyrë ta rekomandojë zbatimin e masave për t'i trajtuar efektet negative të krijuara nga kriza ekonomike.

Pas rekomandimeve, ministria duhet t'i publikojë masat kufizuese obliguese.

Vendimi parasheh masa për 60 ditë, por Kuvendi mund ta vazhdojë edhe për periudha të tjera për nga 30 ditë.

Reduktimet u udhëzuan nga Operatori i Sistemit dhe Tregut - KOSTT për shkak të mbingarkesës në sistemin elektro-energjetik.

Fatura e energjisë elektrike në Kosovë mund të shtrenjtohet për 7 për qind në muajt e ardhshëm. Një rritje të tillë e ka kërkuar Kompania Kosovare për Distribuum të Energjisë Elektrike (KEDS).

## Shkëmbehen përvojat në mes të Kosovës dhe Kroacisë në fushën e planifikimit hapësinor në nivelin lokal



PRISHTINË, 29 DHJETOR (ER) - Asociacioni i Komunave të Kosovës nga 15 deri më 18 dhjetor 2021 ka organizuar vizitën studimore në Kroaci për zyrtarët komunalë për planifikim hapësinor. Qëllimi i vizitës ka qenë që të mësohet nga praktikat më të mira në sektorin e planifikimit hapësinor dhe mësimi nga përvojat e Kroacisë në sektorin e planifikimit hapësinor me fokus të veçantë në qeverisjen lokale. Gjatë vizitës përfaqësuesit e komunave kanë zhvilluar vizita dhe janë shkëmbyer përvoja me Departamentin e Planifikimit Hapësinor në kuadër të

Ministrisë së Ndërtimit, Planifikimit Hapësinor dhe Pronës Shtetërore (MCSPSP), Kroaci, Zagreb. Temat që u diskutuan me Bojan Linardiç, drejtor i Departamentit për Planifikim Hapësinor dhe përfaqësuesit e tjerë të nivelit qendror, ishin: Korniza ligjore në planifikimin hapësinor; Dokumentet e planifikimit hapësinor dhe autoritetet përgjegjëse për të gjitha llojet e dokumenteve të planifikimit hapësinor; Zbatimi i kuadrit ligjor; Komunikimi vertikal në planifikimin hapësinor/nivel lokal dhe qendror.

## Në përvjetorin e rënies përkujtohet heroit Mehë Uka

MITROVICË, 29 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, i shoqëruar nga nënkryetari Arian Tahiri, drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Bahtir Maxhuni, si dhe përfaqësuesit nga shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, kanë vendosur buqeta me lule të freskëta te shtatorja e heroit të kombit Mehë Uka në sheshin e qytetit me rastin e 25-vjetorit të rënies së tij heroike. Përmes këtyre homazheve kryetari Hamza ka thënë se po

përkujtohet sakrificën sublime e heroit të kombit Mehë Uka, i cili dha jetën për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë. "Sot, bashkë me stafin tim dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, në 25-vjetorin e rënies së heroit Mehë Uka, po përkujtojmë sakrificën dhe veprën e tij për liri dhe pavarësi, si dhe luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lavdi heroit Mehë Uka! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!", është shprehur kryetari Hamza.



## Ministri i Mbrojtjes i Turqisë bën homazhe në Prekaz

Skenderaj, 29 dhjetor (ER) - Ministri i Mbrojtjes Kombëtare të Republikës së Turqisë, Hulusi Akar, i shoqëruar edhe nga ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, ka bërë

nderime te varri i komandantit legjendar Adem Jashari dhe Jasharëve heroikë në Prekaz. "Emocion i veçantë kur nderohet nga miqtë tanë sakrificat historike e kombit tonë

liridashës, pikërisht në sheshin e lavdisë madhështore të Jasharëve legjendarë. Ju faleminderit miku ynë, ministër Akar!", ka shkruar Mehaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Bulliqi thotë se opozita është duke bllokuar zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit

PODUJEVË, 29 DHJETOR (ER) - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka thënë se partitë opozitare janë duke bllokuar zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit komunal. Kjo deklaratë e tij erdhi pasi në rend të ditës ishte zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF).

Për kryesues të kuvendit u propozua vetëm një kandidat, Adelinë Stublla nga grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje!, ndërsa partitë e tjera të përfaqësuara në kuvend nuk patën propozime. Në seancën e Kuvendit Komunal, Bulliqi ka kërkuar shtyrjen e seancës, në mënyrë që të marrin kohë

për diskutim dhe për gjetjen e një rrugëzgjidhje për zgjedhjen e trupave të kuvendit. Në këtë seancë u betuan dy anëtarët e rinj të kuvendit, Fahri Hasani nga LDK-ja dhe Mimoza Abdullahu-Stublla, të cilët zëvendësuan Ekrem Hysenin dhe Floretë Zejnullahun.



# Qeveria miraton Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Qeveria ka votuar Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme si dhe Projektkodin Civil të Republikës së Kosovës

Në mbledhjen e 52-të të qeverisë, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka paraqitur këto dy projektligje dhe të njëjtat morën mbështetjen e kabinetit qeveritar. Në mbledhjen e qeverisë u tha se Projektligji për themelimin e Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme është hartuar me kujdes të veçantë dhe duke pasur parasysh dispozitat kushtetuese, legjislativon në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Me miratimin e këtij projektligji kompletohet legjislativi me fokus në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përkatësisht konfiskimit të pasurisë që nuk mund të justifikohet.

Ministrja Haxhiu ka theksuar se nga vlerësimi përmes koncept-dokumentit ka rezultuar që është me interes shoqëror që sistemit juridik t'i shtohet edhe Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, i cili, sipas saj, do të ketë fokus vlerësimin e pasurisë së zyrtarëve publikë në raport me të hyrat e tyre. Ajo ka thënë se i njëjti është hartuar me kujdes të madh duke pasur për

bazë kushtetutshmërinë, ligjshmërinë dhe standardet ndërkombëtare.

Po në këtë mbledhje u miratua edhe Projektkodi Civil i Republikës së Kosovës, i cili është në funksion të zhvillimit dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës.

Kodifikimi i të Drejtës Civile, pra nxjerrja e Kodit Civil të Republikës së Kosovës, ka për qëllim unifikimin dhe harmonizimin e ligjeve të fushës civile në një tërësi.

Sipas ministres Haxhiu, Kodifikimi i të Drejtës Civile, pra nxjerrja e Kodit Civil të Republikës së Kosovës, ka për qëllim unifikimin dhe harmonizimin e ligjeve të fushës civile në një tërësi-kod (ligj i veçantë) që përmbledh në vete ligjet e harmonizuara të fushës së njëjtë si: detyrime, pronësore, familjare, trashëgimore.

Në këtë mbledhje u miratua edhe Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që ka të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive ekzekutive. Pas shqyrtimit u miratua edhe Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Statusin e Forcave në mes të Republikës së Kosovës dhe shtetit të Kuvajtit.

Kabineti qeveritar miratoi edhe Projektligjin për Ushqim, qëllimi i të cilit është përcaktimi i parimeve dhe kërkesave të përgjithshme për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshët, masave dhe procedurave lidhur me ushqimin dhe



## Dërgohet në Kuvend Projektligji që e rregullon punën e qeverisë

Qeveria ka marrë vendim që të procedojë për në Kuvend Projektligjin që rregullon punën e ekzekutivit. Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka thënë se Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e vendit dhe se përcakton mandatin dhe kompetencat dhe e qeverisë. "Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston me mbulimin e fushës së organizimit dhe funksionimit të Qeverisë së Kosovës, mënyrën e punës dhe procedurat e vendimmarrjes, i vendos parimet udhëheqëse të qeverisë si pushtet ekzekutiv, me parimin e respektimit të ligjit, përgjegjshmërisë, transparencës, barazisë gjinore si dhe nga parimi i efikasiteti. Projektligji është në përputhje me Kushtetutën", ka deklaruar Kurti.

ushqimin për kafshët, si dhe përcaktimin e autoritetit kompetent për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshët. Me vendim të qeverisë u miratua vendimi preliminar për shpronësim për interes publik i pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga realizimi i projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploitim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-sh.a), Zonat Kadastrale: Hade, Shipitullë, Palaj, Leshkoshiq, dhe Sibovc, Komuna Obiliq.

## Drejtori i ShSKUK-së kërkon zbatim të planit për menaxhimin e pandemisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka mbajtur takim me drejtorët e spitaleve të përgjithshme. Në takim është diskutuar plani i spitaleve të përgjithshme për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve me Covid-19.

Drejtori i ShSKUK-së ka kërkuar nga drejtorët e spitaleve të kenë angazhim dhe vigjilencë maksimale për zbatim të planit për menaxhim dhe trajtim të rasteve me Covid-19. Sipas tij, edhe pse aktualisht situata është e qetë dhe nuk ka raste të spitalizuara me variantin Omicron, spitalet duhet të jenë në gatishmëri të plotë, që në rast të paraqitjes së rasteve të kenë të gatshme hapësirat dhe stafin e nevojshëm për ta ofruar trajtimin

e nevojshëm shëndetësor.

ShSKUK ka planin për menaxhim të rasteve me Covid-19, në rast të ndonjë vale të re të mundshme me Covid-19, në nivel të klinikave të QKUK-së dhe spitaleve të përgjithshme. Në katër spitale të përgjithshme nuk ka pacientë të shtrirë me Covid-19.

Spitali i Gjakovës, Mitrovicës, Gjilanit dhe Vushtrrisë nuk kanë pacientë të shtrirë me Covid-19. Bazuar në raportin e datës 29 dhjetor 2021, në tërë ShSKUK-në të shtrirë janë 8 raste të konfirmuara me Covid-19 pozitive dhe 33 raste të tjera post-Covid-19.

Me oksigjenoterapi janë 8 pacientë, kurse në Mjekimin Intensiv të Klinikës Infektive janë duke u trajtuar dy pacientë.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të mërkurën se prej 3 058 testeve, 33 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin



Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Sipas këtij njoftimi, janë shënuar edhe 12 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është

158 028.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 371.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 3 047 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 669 230 doza të vaksinës.

Deri më sot 781 351 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

# ATK-ja: 591.4 milionë euro të inkasuara ose 34.5 milionë euro më shumë se projeksioni për këtë vit

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Janë shumë aktivitete, rezultate dhe sfida me të cilat Administrata Tatimore e Kosovës gjatë këtij viti është ballafaquar, por ky vit do të karakterizohet për një performancë jashtëzakonisht të mirë për inkasimin e të hyrave, për rritjen e efektivitetit për trajtimin e borxheve, në avancimin e shërbimeve digjitale ndaj tatimpaguesve si dhe për rritjen e llogaridhënies dhe

përgjegjësisë. Në këtë konferencë për medie, pjesës e së cilës ishte edhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Heuran Murati, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, kanë njoftuar se janë inkasuar 591.4 milionë euro tatime, të cilat kanë tejkaluar projeksionin për këtë vit për 34.5 milionë euro, i cili, në fakt, ishte 556 milionë euro. Veç këtyre mediet u njoftuan se janë inkasuar 130.9 milionë euro borxhe si rezultat i trendit pozitiv të punës që është duke bërë departamenti përkatës. Murtezaj ka thënë se inpute

mjaft të rëndësishme për realizimin e objektivave kyçe të institucionit janë reformat që janë në fusha të caktuar me interes për tatimpaguesit, siç është reforma në trajtimin e borxheve, rimbursimin e TVSh-së, ku mesatarja e kthimit të rimbursimit deri në nëntor të këtij viti është ulur në 13 ditë nga 30 ditë, për sa edhe është bërë reforma në këtë aspekt.

Po ashtu u përmend fakti se nga kontrollet e bëra te bizneset janë vlerësuar 64.1 milionë euro tatim shtesë, si dhe 2.2 milionë euro nga rastet

e konstatuara për shmangie tatimore. Këtë vit platforma e deklarimit elektronik ka arritur 100 për qind të shërbimeve digjitale ndaj tatimpaguesve, ku tatimpaguesit tani të gjitha shërbimet i kanë në dispozicion në platformën e-deklarimi, pa pasur nevojë që t'i frekuentojnë zyrat e ATK-së. Murtezaj të mërkurën ka lansuar edhe aplikacionin elektronik për verifikimin e punëtoreve i cili ka për qëllim ofrimin e mundësisë së shpejt dhe të thjeshtë, me pak të dhëna, për ta verifikuar veten

një punëtor nëse është i deklaruar nga punëdhënësi i tij.

Ministri Murati ka thënë se, pavarësisht prej sfidave që ka pasur si rezultat i pandemisë, ky vit e karakterizon ATK-në si shumë të suksesshme, pasi që ka arritur t'i tejkalojë planet e parapara nga qeveria si në planin fillestar, po ashtu edhe në planin e rishikuar. Gjithashtu, ministri Murati u zotua se do ta vazhdojë përkrahjen ndaj ATK-së me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve institucionale si dhe arritjes së objektivave.



## Kurti falënderon Shqipërinë për ndihmën me energji elektrike



PRISHTINË, 29 DHJETOR (ER) - Kryeministri Albin Kurti ka falënderuar Edi Ramën për ndihmën që Shqipëria i ka dhënë Kosovës lidhur për ndihmën me energji elektrike. Kurti në një konferencë për medie është shprehur se kompensimi me nga ana e Kosovës do të bëhet gjatë verës

kur Shqipëria ka më së shumti nevojë për rrymë. "Ne e falënderojmë kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, për mbështetjen. Ministrja jonë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, e ka bërë një kërkesë të tillë ndaj Shqipërisë për shkak se jemi komplementarë. Ne kemi termocentrale, ata kanë

hydrocentrale dhe bëhet fjalë për dy ditë, e më pastaj ne do të kemi mundësi t'i ndihmojmë në rast të nevojës, pra verën e vitit të ardhshëm. Edhe Shqipëria nuk ka ndonjë bollëk që të na ndihmojë, por në kushtet që i ka, Shqipëria ka shprehur vullnetin të na ndihmojë", ka thënë Kurti.


## Kosova lanson 'e-Testimi' për patentëshofer, zbatimi nga janari 2022

Prishtinë, 29 dhjetor (ER) - Nga 5 janari i vitit 2022 në shtatë qendrat e patentëshoferëve në gjithë Kosovën do të zbatohet "e-Testimi". Kandidatët për patentëshofer

do të testohen në mënyrë elektronike dhe menjëherë pas përfundimit të testimit do të kenë mundësi ta kuptojnë rezultatit e testit. Zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen

Durmishi, ka thënë se përmes këtij projekti do të lehtësohet puna e njëjësive të patentëshoferëve, duke shtuar se do të eliminohet edhe mundësia që përmes aferave korruptive të pajisjen

qytetarët me patentëshofer. Projekti për "e-Testim" për patentëshofer ka nisur si pilot në vitin 2016 dhe deri më tani ka qenë i praktikuar vetëm në njërin njësi në qendrën për patentëshofer në Prishtinë.





# Si do të stabilizohet klima e planetit? Shkencëtarët po analizojnë çfarë ka ndodhur në të kaluarën e largët



Për shkak të emetimeve të shfrenuara të gazeve serrë, planeti ynë po përjeton një krizë klimatik serioze. Ne ende kemi akull nga periudhat më të ngrohta të Pleistocenit, edhe pse temperatura e globit po i afrohet niveleve më të ngrohta të Pliocenit 3 milionë vite më parë.

Ndërkohë, niveli aktual i dioksidit të karbonit (CO<sub>2</sub>), është i ngjashëm me atë në periudhën midis Pliocenit dhe Miocenit rreth 10 milionë vite më parë, teksa rrezikojmë të kemi një epokë të re Eocenike të temperaturave shumë të larta, e cila nuk është parë në 40 milionë vjet.

Në një moment, kjo krizë do të kalojë në një ekuilibër të ri. Por kur do të ndodhë kjo? Dhe si do të duket ky ekuilibër? Pjesa më e madhe varet nga ne njerëzit, bazuar tek ajo se sa shpejt do të arrijmë të zerojmë emetimet e gazeve serrë. Por nga ana tjetër varet gjithashtu nga sa planeti ynë është "i ndjeshëm" ndaj gazeve serrë, dhe sa shpejt reagon ndaj ndryshimeve. Zbulimi i ndjeshmërisë së planetit tonë ndaj gazeve serrë, është dokumentuar nga shkencëtarët që nga vitet 1970, por vendet i kanë rezistuar me kokëfortësi për përpjekjeve për t'i kufizuar këto

emetime.

Nëse dyfishohen nivelet e CO<sub>2</sub>, mund të kemi një rritje temperaturash në nivelin 1.5 deri në 4.5° C. Ky është një diapazon i gjerë, dhe ka të ngjarë që ne të dyfishojmë nivelet para industriale të CO<sub>2</sub> brenda këtij shekulli, ndonëse duam të shmangim ngrohjen mbi nivelin 2°C.

Një pjesë e pasigurisë që kemi mbi këtë çështje, buron nga fakti se instrumentet tona arrijnë të gjurmojnë vetëm një pjesë të shkurtër epokës me klimë të ftohtë që kemi lënë pas. Deri në vitin 2100, temperaturat globale mund të rriten midis 2.7-3.6°C krahasuar me epokën para industriale. Ky temperaturë do të jetë më e lartë sesa gjatë gjithë Holocenit, periudha gjeologjike që nga akullnajat e fundit, në të cilën lulëzoi shoqëria përmes bujqësisë, qyteteve dhe industrisë. "Po flasim për një ngrohje të ngjashme me epokën e Pliocenit"-thotë dr.Xhesika Tiernej e Universitetit të Arizonës.

Gjatë Pliocenit, paraardhësit tanë ishin australopiteket, të cilët nuk ishin ende plotësisht të gatshëm të jetonin larg pyjeve. Shumica e akullit që ndodhet aktualisht në Grenlandë dhe Antarktidën

Perëndimore nuk ishte aty, dhe nivelet e detit ishin midis 5-25 metra më të larta se sa në vitin 1900.

Ndërkohë gjatë epokës akoma më të ngrohtë të Miocenit, paraardhësit tanë ishin ende majmunë, nivelet e detit ishin ndoshta 48 metra më të lartë, dhe pjesë të Antarktidës ishin të pyllëzuara. "Klimat e epokave të lashta, janë konteksti ynë i vetëm mbi atë se si mund të jetë një Tokë më e ngrohtë"- shton Tirnej.

Meqë në atë kohë nuk kishte termometra apo spektroskopë me rreze infra të kuqe, shkencëtarët përdorin matjet indirekte apo objekte "përfaqësuese", që e ndryshojnë përbërjen e tyre kimike, izotopike ose fizike, në proporcion me ndryshimet në temperaturë, nivelet e CO<sub>2</sub> apo edhe reshjet.

Vlerësimet për temperaturat gjatë Eocenit ndryshojnë shumë. Dihet që ajo ka qenë një nga periudhat më të nxehta të historisë së planetit tonë, me kushte që mendohet se përputhen me të ardhmen tonë në një klimë ekstreme. Por vlerësimet sesa më shumë nxehtë ishte në krahasim me epokën tonë para industriale variojnë nga 9 në 23°C.

Dr.Gordon Inglis i Universitetit

të Sauthemptonit në Angli, analizoi me kujdes me ndihmën e kolegëve një koleksion të madh objektësh "përfaqësuese". Vlerësimi i ekipit mbi temperaturat e hershme të Eocenit, sugjeron se ajo epokë ishte midis 10-16°C më ngrohtë, se sa epoka para industriale.

Por ndryshe nga sot, Plioceni, Mioceni dhe pjesa më e madhe e Eocenit nuk ishin klima që u shfaqën shumë shpejt në kohë. Përkundrazi, ato ishin rezultat i miliona viteve përshtatjeje, dhe kur emetimet vullkanike të CO<sub>2</sub> balanoheshin nga "varrosja" e CO<sub>2</sub> nën Tokë.

Bimësia, akulli dhe temperaturat, ishin të gjitha në harmoni me nivelet e CO<sub>2</sub> dhe ndikimin periodik të lëkundjeve orbitale që pësonte Tokas. Klima jonë ka sot më shumë të përbashkëta me ndryshimet e dikurshme të CO<sub>2</sub>, të shkaktuara nga emetimet jashtëzakonisht të mëdha vullkanike.


Një shembull relativisht i moderuar është Maksimumi Termik Paleocen-Eocen (PETM), 56 milionë vjet më parë, kur gjatë disa mijëvjeçarëve në atmosferë, vërshuan sasi të mëdha të CO<sub>2</sub> dhe gazit metan, duke e ngrohur globin me 5°C shtesë.

Ajo ishte një kohë që të kujton atë të sotmen, me acidifikimin e oqeanit, detet e "uritura" për oksigjen, zhdukjet e specieve dhe përmbytjet e mëdha. Ngrohja globale aktuale, po prodhon tashmë një mot ekstrem të paprecedentë: rrebeshe të forta shiu, valë të gjata të të nxehtit ekstrem, thatësira dhe zjarre, të cilat pritet të përkeqësohen.

Kjo është ajo që ne shohim edhe në klimat e dikurshme. Nga këto më e frikshme është rritja e nivelit të deteve. Nëse do të kemi një situatë të ngjashme si në epokën e Pliocenit, niveli i deteve do të jetë rreth 5-25 metra më i lartë mbi nivelin aktual, gjë që do të sillte përmbytjen e pjesës më të madhe të bregdetit lindor të SHBA-së.

Sesa kohë do të duhet që të mbërrihet në këtë pikë, kjo do të varet nga fakti nëse akujt do të shkrijnë ngadalë apo me shumë shpejtësi. Në rastin e parë, nëse e dalim rritjen deri në 2°C, do të kemi një rritje afro 50 centimetra të nivelit të detit deri vitin 2100. Mjerisht, nivelet do të rriten për disa mijëvjeçarë, derisa të arrijnë një nivel 8-13 metra më të lartë si në epokën e Pliocenit brenda 10.000 vjetësh.

Marrë me shkurtime nga  
Ars Technica – Bota.al



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## KON-i 'kërcënon' Serbinë për Kosovën

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Komiteti Olimpik Ndërkombëtar e ka paralajmëruar Serbinë me ndalesë të organizimit të ngjarjeve të mëdha sportive nëse nuk e lejon pjesëmarrjen e garuesve nga Kosova. Padrejtësive të Serbisë karshi Kosovës në sport duket se po u vjen fundi. Shteti fqinj e ka marrë një paralajmërim të ashpër nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. IOC ia ka ngrehur veshin Serbisë dhe Malajzisë, të cilët po refuzojnë t'i lejojnë sportistët nga vende të caktuara për të marrë pjesë në garat që i organizojnë ato. Shtëpia e sportit ndërkombëtar i

ka kërcënuar këto dy shtete me ndalesë të organizimit të ngjarjeve të mëdha sportive nëse e përsëritin gabimin për arsye politike. IOC-ja u ka dërguar letra të dyja Komiteteve Olimpikë Nacionale duke ua bërë me dije paralajmërimin nëse vazhdojnë me politika të njëjta, shkruan "insidethegames". Qeveria serbe ia pamundësoi Kosovës të marrë pjesë në Kampionatin Botëror të Boksit, i cili u mbajt disa javë më parë. IOC-ja ka kërkuar nga Komiteti Olimpik Nacional i Serbisë dhe i Malajzisë që ta zgjidhin çështjen me qeveritë përkatëse. Me këtë rast, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ka



kërkuar që të gjithë sportistët të konsiderohen të barabartë dhe të respektohen njëjtë. Në letër tutje shkruhet se tash e tutje

IOC-ja do të jetë mjaft vigjilente para se t'ua japë organizimin e ngjarjeve sportive shteteve të caktuara. Boksierëve kosovarë,

në fakt, iu ndalua futja në territorin serb tri herë brenda 24 orësh. Ky vendim ishte kritikuar nga Federata Ndërkombëtare e Boksit dhe Komiteti Olimpik Ndërkombëtar. IOC-ja madje e kishte kritikuar IBA-n që ia ka dhënë Serbisë të drejtën e organizimit të Botërorit të Boksit pa e sqaruar çështjen me Kosovën. As në të kaluarën sportistët kosovarë nuk janë lejuar të futen në territorin serb. Malajzia ndërkohë ka probleme me Izraelin dhe nuk i lejon garuesit e këtij vendi të futen në territorin e saj. Edhe Irani e kishte një problem të tillë me sportistët izraelitë.

## Hidhet shorti për çerekfinale, derbi në mes të Pejës dhe Prishtinës

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Në bazë të Rregullores së Kupës së Kosovës, Sistemit të Bergerit pas 14 xhirove të zhvilluara në ART Motion Superligë, është hedhur shorti për Final 8 Kupën e Kosovës në basketboll në konkurrencën e meshkujve. Në çerekfinale Golden Eagle Ylli si lider i tabelës do të përballlet me vendin e fundit në renditje, Dritën. Takim shumë interesant pritet në mes të Trepçës dhe Rahovecit, dy skuadra që synojnë ta fitojnë trofeun e çmuar të Kosovës. Në çerekfinale

do të përballen rivalët e vjetër në basketbollin e Kosovës, Peja dhe Sigal Prishtina. Këto dy skuadra u përballën edhe për Superkupë, ku pejanët depërtuan në gjysmëfinale. Sfidat mes këtyre dy skuadrave gjithmonë kanë qenë interesante dhe kështu pritet edhe këtë herë në garat e Kupës. Rivalët lokalë Prizreni 16 dhe Bashkimi do të takohen në çiftin e fundit çerekfinal. Të dyja skuadrat synojnë të kalojnë në gjysmëfinale. Ndashjet çerekfinale do të zhvillohen më 9 dhe 10 shkurt 2022, kurse turneu

do të zgjasë deri më 13 shkurt 2022. Fituese aktuale e Kupës është Sigal Prishtina. Në gjysmëfinale do të përballen fituesit e çiftit Golden Eagle Ylli - Drita dhe Prizreni 16 - Bashkimi, si dhe Trepça - Rahoveci me Peja - Sigal Prishtina.

### ÇEREKFINALET

Golden Eagle Ylli - Drita  
Trepça - Rahoveci  
Peja - Sigal Prishtina  
Prizreni 16 - Bashkimi



## Ditë e suksesshme për skitarët e Kosovës në Kollashin

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Një ditë e mbarë dhe me shumë suksese për Përfaqësuesen e Kosovës në skitari, e cila po merr pjesë në garat që po mbahen në Kollashin të Malit të Zi, disiplina e sllallomit dhe sllallomit të madh. Në garën e së mërkurës në sllallom të madh, Kiana Kryeziu u bë femra e parë që përmbush një nga pesë kriteret e nevojshme për normë olimpikë për Lojërat Olimpikë



Dimërore "Pekini 2022". Për ta fituar normën për "Pekin 2022", Kianës i duhen edhe katër

rezultate të tilla në sllallom të madh, deri më 16 janar 2022. Një garë tjetër e ka edhe sot (e mërkurë), pikërisht në Kollashin. Në këtë konkurrencë Arba Pupovci doli e dhjeta. Kryeziu zuri vendin e katërt nga 17 garues, duke mbledhur 148.61 pikë të Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS). Koha e saj ishte 2 minuta e 02.00 sekonda. Sukses arriti edhe Arbi Pupovci, i cili

kompletoi kriteret për normën olimpikë edhe në sllallom të madh. Ai zuri vendin e nëntë nga 33 garues, konkurrenca e meshkujve, duke mbledhur 114.08 pikë të FIS-it. Koha e tij ishte 1 minutë, 54.84 sekonda. Arbi normën e ka edhe në disiplinën e sllallomit. Drin Kokaj përmbushi kriterin e parë për normë olimpikë edhe në sllallom të madh, duke mbledhur

148.80 pikë. Ai doli i 12-ti me kohë 1:58.64. Përzgjedhësi i Kosovës, Agim Pupovci, deklaroi për KOK-un se rezultatet e sotme janë fryt i përgatitjeve dhe punës intensive të bërë gjatë vitit 2021 me garuesit, për çka pret që edhe sot (e enjte), në garën e fundit për këtë vit, të përsëritet ky sukses. Gara për normën olimpikë "Pekini 2022" mbyllet më 16 janar 2022.

## Brown përforcon KB Prishtina

PRISHTINË, 29 DHJETOR - KB Sigal Prishtina është përforcuar me basketbollistin amerikan Kenny Brown. Kampionët e shumëfishtë të Kosovës kanë njoftuar zyrtarisht të mërkurën se kanë përforcuar radhët e veta me

basketbollistin 189 cm. Brown te Prishtina vjen nga Hungaria, ndërsa karrierë ka bërë edhe në Amerikë, Lindje të Mesme dhe Evropë. Te Prishtina e konsiderojnë 30-vjeçarin si ndihmë shtesë të ekipit në rrugëtimin drejt

objektivave. "Sigal Prishtina ka sjellë një 'dhuratë' në prag të Vitit të Ri, duke transferuar fundorin amerikan Kenny Brown. Brown i gjatë 189 cm që luan në pozitë një dhe dy ka karrierë të bujshme në Amerikë, Lindje të Mesme,

Evropë, ku në Prishtinë vjen direkt nga Rumania. Amerikani 30-vjeçar do të jetë ndihmë shtesë e ekipit për objektivat e klubit në Superligë, Kupë e Balkan League", thuhet në njoftimin e Sigal Prishtinës.



## Morina, sportisti i vitit 2021 në Suharekë

Prishtinë, 29 dhjetor - Basketbollisti i Kosovës dhe Golden Eagle Yllit, Gëzim Morina, është shpallur Sportisti i Vitit 2021 në komunën e Therandës. Ai në vitin 2021 fitoi Ligën Unike, në edicionin e

parë të kësaj gare, Superligën e Kosovës dhe Superkupën Mbarëkombëtare. Morina, gjithashtu, është pjesë e rëndësishme e Përfaqësueses A, ku së fundi shënuan fitore ndaj Danimarkës. "Jam tejet i lumtur

dhe krenar për fitimin e këtij çmimi. Dua t'i falënderoj bashkëlojtarët, stafin e trajnerëve, bordin dhe sponsorët e klubit, tifozët 'Xhebrailat', qytetarët e Suharekës dhe familjen për

përkrahjen dhe ndihmën e tyre gjatë këtij rrugëtimi. Viti 2021 ishte tejet i suksesshëm për komunën tonë. Të gjithë sportistët dhe sportistet i përgëzoj për angazhimin e tyre dhe u uroj shëndet dhe suksese



edhe më të mëdha në vitin që po vjen", ka thënë Morina.

## Disfata surprizuese për Golden State, 'bie' edhe Clevelandin

SAN FRANCISCO, 29 DHJETOR - Është disfata në shtëpi e Golden State kundër Denver surpriza e madhe e mbrëmjes së NBA. Një humbje e pabesueshme në shifrat 86-89 për Warriors që edhe pse mbeten në krye të klasifikimit me 27 fitore dhe 6 humbje, ranë përballë Denverit që ngjitet në këtë mënyrë në zonën "play-off" me 17 suksese dhe 16 humbje. Curry shënoi 23 pikë, Jokiq u përgjigj me 22 pikë por mbi të gjitha edhe me 22 rikuperime. Ishte ky çelësi për fitoren e Nuggets që pasi kishte qenë para me 24 pikë në pushimin mes pjesëve rrezikoi të bëhej pre e një përmbyseje të pabesueshme. Tabela e rezultatit tregonte në fakt barazim 84-84 pak sekonda nga fundi, por në finale Warriors ju mungoi diçka dhe në fund ndeshja shkoi për Denverin. Disfatë e shëmtuar edhe për Cleveland Cavaliers që humbën me përmbyseje 108-104 përballë New Orleans duke pësuar disfatën e 14 sezonale, ndërsa për Pelicans ky ishte vetëm suksesi i 13 në 35 ndeshje. Nuk ndryshon klasifikimi me Clevelandin gjithmonë të blinduar në zonën "play-off" ndërsa New Orleans mbetet në zonat e ulëta por për Cavaliers mbetet një hap fals sidomos për mënyrën se si erdhi humbja. Të



padobishme 27 pikët e Rubio dhe 24 të Love, pasi të zotët e shtëpisë ju përgjigjën me 26 të Jones për të për të realizuar një përmbyseje të madhe pasi kishin qenë në disavantazh përgjatë gjithë ndeshjes, duke arritur deri në një diferencë prej 23 pikësh, New Orleans bëri një mrekulli duke rikuperuar pasi shfrytëzoi dhe shterimin e energjive të kundërshtarëve. Ringrihen më në fund Los Angeles Lakers që pas pesë disfatave radhazi mposhtën 123-132 Houston Rockets që po përjeton një krizë pa fund, pasi pësuan humbjen e pestë radhazi dhe të 25 sezonale duke mbetur në vendin e fundit të klasifikimit. Los Angeles Lakers marrin një frymëmarrje të mirë oksigjeni dhe shpresojnë ende të "play-off"-i të udhëhequr nga 32 pikë, 11 rikuperime dhe 11 asistime nga LeBron James. për kalifornianët

paraqitje e mirë edhe nga Monk me 25 pikë, ndërsa për Houstonin nuk mjaftuan 24 pikët e Green. Ndeshja ishte e ekuilibruar deri në gjysmë të periodes së fundit kur rezultati ishte 115-115, por që aty Lakersat gjetën forcën për t'i futur një marsh më shumë dhe firmosën rezultatit e pjesshëm vendimtar 17-7 që hodhi knockout të zotët e shtëpisë. Vjen fitorja e katërt radhazi për Milwaukee Bucks që mposhtën 110-127 Orlando Magic për t'u ngjitur në kuotën e 23 sukseseve sezonale në 36 ndeshje. Për Orlandon është një periudhë e zezë me humbjen e 28-të në një kampionat për t'u harruar. Të padobishme për të zotët e shtëpisë 38 pikët e Wagner, pikëshënuesi më i mirë i takimit, ndërsa për kampionët në fuqi të NBA, mendoi i zakonshmi Giannis Antetokounmpo, me 28 pikë, 6 asistime dhe 6 rikuperime, duke u mbështetur mirë edhe nga Middleton që realizoi 21 pikë. Bucks komanduan përgjatë gjithë takimit dhe në pushimin mes pjesëve ndeshja ishte praktikisht e mbyllur me një avantazh prej 27 pikësh. Në periudhën e tretë kur Orlando provoi të reduktonte disavantazhin ishte shumë vonë dhe miqtë administruan rezultatit deri në sirenën përfundimtare.

## Shqipëria do të luajë miqësore me Spanjën

Tiranë, 29 dhjetor - Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë një ndeshje miqësore me Spanjën më 26 mars të vitit 2022. Departamenti i Komunikimit në FShF bën me dije se të dyja federatat kanë rënë dakord për zhvillimin e kësaj ndeshjeje në Spanjë, ndërsa stadiumi dhe ora e takimit do të përcaktohen në javët në vijim. Kjo do të jetë ndeshja e parë miqësore mes këtyre dy përfaqësuesëve të cilat deri më tani kanë luajtur ndaj njëra-tjetrës shtatë sfida, të gjitha të vlefshme për kualifikueset e kampionateve evropiane dhe botërore. Shqipëria ka zhvilluar dy ndeshje me Spanjën,



në kuadër të kualifikuesëve të Kampionatit Evropian 1988. Ndeshja e parë u zhvillua në vendin tonë, në stadiumin "Qemal Stafa" më 3 dhjetor të vitit 1986 dhe u fitua nga spanjollët me rezultatit e

ngushtë 1-2. Goli i vetëm për kuqezinjët u shënuar nga Shkëlqim Muça, ndërsa në ndeshjen e dytë në Spanjë, më 18 nëntor 1987, Shqipëria u mund me shifrat 5-0. Ndërkaq, sfida e tretë, e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Evropian 1992, u zhvillua në Spanjë, më 19 dhjetor 1990, që përfundoi në favor të spanjollëve që fituan 9-0. Katër sfidat e tjera janë zhvilluar të gjitha në kuadër të kualifikuesëve për Kampionat Botëror, përkatësisht Kampionati Botëror 1994 dhe Kampionati Botëror 2018, ku Shqipëria nuk ka arritur të fitojë asnjë prej këtyre ndeshjeve.

### SHKURT

#### Abedini rikthehet te Winterthuri

Eris Abedini është rikthyer edhe zyrtarisht te Winterthuri. Lojtari shqiptar ishte transferuar te skuadra nga liga e dytë e Zvicrës në vitin 2019 nga Lugano në formë huazimi në afatin e janarit. Por, Abedini më pas ishte rikthyer te Lugano, për të kaluar më pas te Wil 1900, më pas te Granda, për të përfunduar te Chiasso. Mesfushori defanziv tani i është bashkuar Winterthurit, duke nënshkruar kontratë deri në vitin 2023. Abedini do të luajë me skuadrën zvicerane në Challenge League (D2), duke shpresuar që në të ardhmen e afërt të kalojë në elitën e futbollit zviceran. Mesfushori luan aktualisht për grupmoshat U21 të Kosovës, e që një formë e lartë e tij mund t'i sigurojë edhe një vend në ekipin e parë të "dardanëve".

#### Osaka rikthehet në Australian Open

Tenistja japoneze Naomi Osaka, ish-numri një në botë për femra dhe kampione në fuqi e grand slam të Australian Open (e ka fituar dy herë këtë turne), ka konfirmuar pjesëmarrjen në turneun e parë të madh të vitit 2022 që zhvillohet në Melburn. Duket se Osaka e ka kaluar krizën (probleme psikologjike) që pati në mesin e vitit të kaluar dhe tashmë është gati për t'u rikthyer në fushë. Ajo ka postuar një foto në rrjetet sociale ku duket në avion, me destinacion Australinë. "Ka ardhur koha të ndërroj faqe dhe jam gati për t'u rikthyer në fushë. Jam kampione në fuqi në Melburn dhe synoj të mbroj atë titull", ka thënë Naomi Osaka (aktualisht numri 5 në botë), që në tre muajt e fundit nuk ka marrë pjesë në asnjë turne. Ajo ka gjetur motivimin e duhur për t'u rikthyer në fushë.

#### Covidi 'pushton' Barcelonën

Sikur të mos mjaftonin rezultatet negative në fushë, një tjetër problem ka dalë për Barcelonën. Klubi ka njoftuar se disa lojtarë të tjerë kanë dalë pozitivë me Covid. Dembele, Umtiti dhe Gavi janë emrat më të fundit që i bashkohen listës "kilometrike" të të infektuarve. Dani Alves, Balde, Lenglet dhe Alba ishin ata që dolën pozitivë të parët. Gjithashtu, ka edhe lojtarë të tjerë që priten të mungojnë për shkak dëmtimi apo kartonësh. Busquets, Breithueit, Ansu Fati, Pedri, Robero, Dest dhe Memphis janë emrat e përmendur. Trajneri Xavi me siguri është bërë me dhimbje koke pasi mund ta luajë ndeshjen e ardhshme kundër Majorkës pa gjysmën e ekipit.

#### Terry rikthehet te Chelsea

Legjenda e futbollit anglez, John Terry, zyrtarisht është rikthyer te Chelsea pas disa vjetësh. Terry kishte kaluar tek Aston Villa si lojtar/ndihmëstrajner, duke u zhvendosur më pas në rolin e të fundit. Por, Chelsea ka vendosur që Terry të jetë sërish pjesë e tyre, ndërsa tani do të punojë me akademinë e klubit. Këtë lajm e ka konfirmuar edhe ish-mbrojtësi përmes rrjeteve sociale. "Jam i lumtur të njoftoj se po kthehem në shtëpi dhe kam marrë një rol konsulentë në Chelsea FC akademi. Përveç dhënies së sesioneve të stërvitjes në terren, unë do të përfshihem në diskutimet e stërvitjes dhe mentorimin e lojtarëve të akademisë sonë", ka thënë Terry.

## Mbappe zbulon si është të luash me Messin dhe Neymarin

Në rubrikat e "Gazzetta dello Sport" gjejmë një intervistë të gjatë me sulmuesin e PSG-së, Kylian Mbappe. Mes shumë çështjeve të prekura ka hapësirë edhe për

sulmin yjor të parisienëve, me Messin dhe Neymarin, bashkëlojtarë të francezitet: "Është normale që ka pasur shumë pritshmëri. Të gjithë presin mrekulli kur një ekip

përbëhet nga lojtarë të këtij niveli. Sidoqoftë, nuk duhet t'i harrojmë episodet që shkaktuan disa probleme: lëndimi i Neymarit, faza e adaptimit të Messit, si dhe

disa vështirësi në lojën ekipore. Gjithsesi, kur keni mundësinë të luani me këtë kategori lojtarësh, mund të keni vetëm besim. Të luajturit me ta është një

mundësi e jashtëzakonshme për mua. Mezi pres që Neymari të kthehet, sepse mendoj se mund të bëjmë gjëra të mëdha me të në gjysmën e dytë të sezonit".

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "Auto Transport Muli" SH.P.K. me pronar Bujar Muli Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811480326, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Auto Transport Muli" D.O.O. Bujar Muli Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811480326 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the "Auto Transport Muli" L.L.C. has Bujar Muli Vushtrri, come to the decision to quit its business: 811480326 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Besarta Bardoniqi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III, IV dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

► Elizabeta Sabri Islami shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës së mesme Ekonomike drejtimi Juridik Prishtinë.

► Liridon Rexhaj shpall te pavlefshme dëftesën e kl II dhe diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Votin Kolukaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Heronjtë e Lumes" Vermicë.

► Dyze Daqaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Shtjefen Gjeqovi" Zym.

► Ilami Susuri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII SHFMU "Dëshmorët e Zhurit" Zhur.

► Mert Artan shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX SHFMU "Emin Duraku" Prizren.

► Arian Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" Korishë.

► Uran Shala shpall te pavlefshme certifikatën SHMLT "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

